



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:041249

Datë: 02.12.2020

Numri i dokumentit: 01314247

P.nr.178/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen Zyrtares Ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të pandehurit R.K nga Gjilani, për shkak të veprës penale mospërfillja e gjykatës nga neni 393 paragrafi 1 i KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër PP.II.nr.366/20, të datës 12.03.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, me datë 17.11.2020, mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 02.12.2020 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri R.K, nga babai C... dhe nëna F..., e lindur A...i lindur me datë ..., në ... ndërsa me vendbanim në fshatin ... Komuna e ... ka të kryer shkollën fillore, i shkurorëzuar, baba i dy fëmijëve, punëtor në ndërmarrjen "...", në Gjilan, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 05.03.2020, rreth orës 18:30 minuta në Gjilan, në rrugën "...", nuk i është bindur vendimit gjyqësor për urdhër mbrojtje të gjykatës themelore në Gjilan me shifër C.nr.... të datës 10.01.2020 e as masës së caktuar të ndalimit të afrimit të viktimës së dhunës në familje tani të dëmtuarës D. J nga fshati i komunës së ...t, në atë mënyrë që shkon në lokalit Sh.P.K. "...", ku e dëmtuara kishte filluar të punoj pas ndarjes me të pandehurin, hynë brenda dhe i blen disa gjëra në atë lokal dhe më pas del dhe e pret të njëjtën para lokalit deri sa ajo ta përfundoj orarin e punës dhe më pas i shkon mbrapa e kap për dore dhe nga e njëjta kërkon që të ndalet të flet me të, por e shqetësuar se mundë ti ndodhë diçka prej tij, kjo nuk pranon që të flas por e vazhdon rrugën e saj.

-Me çka ka kryer veprën penale, mospërfillja e gjykatës nga neni 393 paragrafi 1 i KPRK-së.

andaj, gjykata në bazë të nenit 4,38,39,46,47,48,49,69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës dhe neneve 248 e 365 të KPP-ës, të pandehurin R. K:

E GJYKON

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 120 (njëqindnjëzet) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën kohore prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

E dëmtuara D. J, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Obligohet i pandehuri i lartcekur që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 20 € (njëzetë euro) 30 € (tridhjetë euro) si dhe shumë prej 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.

A R S Y E T I M

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 12.03.2020, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr366/20 , kundër të pandehurit R. K nga fshati ... i komunës së ... për shkak të veprës penale mospërfillja e gjykatës nga neni 393 paragrafi 1 i KPRK-së.

Më datë 17.11.2020, në këtë gjykatë është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurorja e shtetit Leonora Kadriu, e dëmtuara D. J dhe i pandehuri R. K me mbrojtësin e tij me autorizim avokatin Kushtrim Isufi. Në këtë seancë i pandehuri pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit, ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë me ç'rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 248 paragrafi 1 të KPRK-ës ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurit.

2.Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë prezente palët e lartcekura dhe pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 248 paragrafi 1 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezente. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij me autorizim, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë deklarata e të dëmtuarës D. J e dhënë në polici, deklarata e të pandehurit R. K e dhënë në polici, Aktvendimet e Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil me numër C.Nr...., i datës 10.01.2020, raportet mjekësore të klinikës së neurologjisë me numër ... dhe ... në emër të të dëmtuarës D. J i si dhe shkresat e tjera të lëndës po ashtu me rastin e pranimi të fajësisë nga ana e të pandehurit gjykata gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri R. K, ka kryer veprën penale mospërfillja e gjykatës nga neni 393 paragrafi 1 i KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit ti shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 120 (njëqindnjëzet) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej 1 viti nuk kryen veprë tjetër penale, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës, gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69,70,71 dhe 72 të KPRK-së, ashtu që rrethanë lehtësuese për të pandehurin ka marrë faktin se i njejt ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë në një fazë të hershme të procedurës penale, se i njejt është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tij dhe ka kërkuar falje për veprimet e tij, faktin se i njejt ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale dhe se do të respektoj të gjitha vendimet e gjykatës, i njejt është zotuar se në të ardhmen nuk do ta shqetësoj të dëmtuarën, gjykata me rastin e caktimi të llojit dhe lartësisë së dënimit ka marrë parasysh edhe rrethanat personale dhe karakterin e të pandehurit ku nga shkresat e lëndës shihet i pandehuri është mbajtës i familjes dhe njëkohësisht i njejt i mbikëqyr 2 (dy) fëmijët e tij të mitur nga martesja me të dëmtuarën D.J e të cilët i janë besuar në mbikëqyrje sipas aktvendimit të kësaj gjykate me numër C.nr.1..... dhe se me të ardhurat që i njejt i siguron ai mbështet të gjithë anëtarët e familjes përfshi këtu edhe dy prindërit e tij të papunë, i njejt, është i gjendjes së varfër ekonomike dhe njëherit faktin se nga shkresat e lëndës shihet se për të pandehurin është hera e parë që i njejt bie ndesh me ligjin përkatësisht i njejt më parë nuk ka qenë i gjykuar e as dënuar për ndonjë veprë penale me aktgjykim të formës së prerë ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurin mori faktin se si pasojë e veprimeve të të pandehurit tek e dëmtuara është shkaktuar frikë, ankth dhe pasiguri për jetë. Me rastin e marrjes së vendimit për shqiptimin e dënimit me kusht përveç tjerash gjykata pati parasysh edhe *qëllimin e dënimit me kusht* i cili konsiston në atë se për veprat penale për të cilat parashihet dënim deri në 5 vite burgim vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme që të ndalojë kryesin të mos kryej vepra tjera penale si dhe *sjelljen e mëparshme të kryesit* ku nga shkresat e lëndës shihet se për të pandehurin është hera e parë që i njejt bie ndesh me ligjin andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

5. Vendimi lidhur më kërkesën pasurore juridike

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata në bazë të nenit 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës për realizimin e kërkesës pasurore juridike, të dëmtuarën D. J e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

6.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Gjykata ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë ta paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzet euro) si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.178/2020, me datë 02.12.2020

Zyrtarja Ligjore,
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Rilind Sermaxhaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjilan.